



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 74/4 Prot.

Tiranë, më 04/02/2022

VENDIM

Nr. 4 Datë 04/02/2022

PËR HAPJEN E THIRRJES PËR APLIKIM PËR PROJEKTET
KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT (PKKZH)
PËR VITIN 2022

Bordi i Administrimit të AKKSHI-së, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Urdherit nr.10, datë 15.01.2021, "Për ngritjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", në mbledhjen e datës 04.02.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së "Thirrjes për aplikim për Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për periudhën 2022-2023", në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Znj. Evis KUSHI, Kryetare

Evis Kushi

Z. Skënder TOPI, Anëtar;

Skender Topi

Znj. Zamira GJINI, Anëtare;

Zamira Gjini

Znj. Eva BICA, Anëtare;

Eva Bica

Z. Vasil S. TOLE, Anëtar;

Vasil S. Tole

Znj. Ines MUÇOSTEPA, Anëtare;

Ines Muçostepa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PROJEKTET KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT (PKKZH) PËR VITIN 2022

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, AKKSHI shpall thirrjen për aplikim për Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit për vitin 2022 në fushat prioritare si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Uji dhe Energjia

I. Institucionet që kanë të drejtë të aplikojnë

Në kuadër të programeve kombëtare, kanë të drejtë të aplikojnë për financim të projekteve të kërkim zhvillimit (PKKZH), Institucionet e Arsimit të Lartë të përcaktuara si të tilla në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 4, pika 4, si dhe institucionet publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor në 6 fushat si më sipër.

II. Buxheti dhe kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja PKKZH është deri në **12 muaj**.

Vlera maksimale e projektit është deri në **2,500,000 lekë**.

Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e personelit (kërkuesve shkencor dhe personel ndihmes) që parashikohen për aktivitete të projektit.

III. Kriteria të përgjithshme për aplikim

1. Projekt propozimi duhet të vijë nga një Institucion i Arsimit të Lartë ose Institucion tjetër sipas përcaktimeve të mësipërme, në përputhje me fushat prioritare dhe sipas kërkesave të udhëzuesit

përkatës të PKKZH (<http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>);

2. Projekt – propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me procesin e kërkimit shkencor, duke përjashtuar blerjen e pajisjeve, dhe mjeteve laboratorike që klasifikohen në shpenzime kapitale.
3. Do të kenë përparësi:
 - Projekt propozimet që kanë lidhje direkte me prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare sipas fushave të mësipërme;
 - Projekt propozime të kerkimit shkencor që vijnë si bashkepunim me institucionet publike qendrore dhe vendore për zgjidhjen e problematikave në sektoret strategjik;
 - Projekt propozimet të kerkimit shkencor që vijnë në bashkepunim me sektorin e biznesit, përbëjnë risi në fushën përkatëse, janë të zbatueshme në një dege të industrisë dhe e konkludojnë me një aplikim për regjistrim kombëtar të patentës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI);
 - Projekt propozimet që vijnë si reagim ndaj situatës së pazakontë të krijuar nga COVID 19, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës si dhe reduktimin e pasojave të pandemisë në fushën social ekonomike;
 - Projekt propozimet që mbështesin kërkimin shkencor në fushat prioritare duke përfshirë në këtë proces kandidatë për studime të doktoratës;
4. Projekt propozimet të cilat, adresojnë prioritetet strategjike kombëtare¹, të Bashkimit European² si dhe të Zonës Europiane të Kërkimit (European Research Area (ERA)³, lidhur me promovimin e barazisë gjinore në shkencë dhe inovacion;

IV. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë:
 - a. Projekt propozimin të hartuar dhe paraqitur **vetëm** sipas formularit standard të aplikimit për PKKZH – të (Aneksi 1 i udhëzuesit <http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>)
 - b. Projekt propozimi dhe dokumentacioni i kërkuar sipas udhëzimit duhet të dorëzohen në 3 kopje të shtypura dhe 1 kopje në CD (përfshirë edhe dokumentat që janë të firmosura e të skanuar), të shoqëruar me një shkresë përcjellëse të institucionit aplikues e firmosur nga titullari i institucionit;
 - c. CV në Shqip e drejtuesit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën gradën “Doktor” në fushën përkatëse;
 - d. Miratimin e titullarit të institucionit për pjesëmarrje në projekt;
 - e. Vetëdeklarim nga Drejtuesi i Projekt që nuk ka aplikuar më parë tek AKKSHI. Nëse ka aplikuar dhe ka qenë fitues, të paraqesë vetëdeklarimin që ka shlyer të gjitha detyrimet;
 - f. Kopje të diplomës së gradës shkencore apo titullit akademik;
 - g. Vendimin e akreditimit të institucionit ku punon;

¹ Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022.

² Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the committee of the regions a Union of Equality: “Gender Equality Strategy 2020-2025”;

³ https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/strategy-2020-2024/democracy-and-rights/gender-equality-research-and-innovation_en#gender-equality-in-the-european-research-area-era

- h. Marrëveshje bashkëpunimi (kuadër ose specifike) midis IAL-ve në rast se projekti vjen si bashkëpunim ndërmjet IAL-ve.
2. Në rast të aplikimit të institucioneve jopublike kërkohet:
- a. Vërtetim nga zyra e tatim taksave vendore, që vërteton që institucioni nuk ka detyrime të prapambetura tatimore dhe të sigurimeve shoqërore;
 - b. Kopje të statutit apo ekstraktit të QKR ku të përcaktohet që aplikuesi ka në fokus të veprimtarisë së tij kërkimin shkencor;
 - c. Evidenca të veprimtarisë së mëparshme kërkimore – shkencore apo pjesëmarrjes/ fitimit të projekteve kërkimore - zhvillimore.
3. Në rastet kur projekt – propozimi vjen si bashkëpunim i universitetit me biznesin dokumentacioni shtesë që duhet të paraqitet është si më poshtë:
- a. Vërtetim nga zyra e tatim-taksave që nuk ka borxhe apo detyrime të pashlyera.
 - b. Kopje të statutit apo ekstraktit të QKB të biznesit.
 - c. Marrëveshje bashkëpunimi (kuadër ose specifike) midis IAL dhe biznesit.

Në të gjitha rastet rastet kur projekt – propozimet përbëjnë risi apo inovacion në fushën përkatëse, aplikantët, pas përfundimit të projektit, duhet të paraqesin aplikimin e tyre për regjistrim kombëtar të patentës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) në përputhje me legjislacionin përkatës.

V. Dorëzimi i aplikimeve

Aplikantët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin **përmes postës zyrtare**, në adresën: AKKSHI, Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, Shqipëri;

Afati i fundit për aplikim është data **07/03/2022**. Aplikimet që mbërrijnë pas kësaj date nuk do të pranohen. Aplikantët të llogarisin kohën që merr shpërndarja e dokumentave me postë.

VI. Informacione shtesë

- a. Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacionin të plotë, kanë pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin e përcaktuar nga AKKSHI do të skualifikohen që në fazën e parë të shqyrtimit teknik.
- b. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programet ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresat: lidjana.shahinaj@nasri.gov.al; tea.gjata@nasri.gov.al.
- c. Udhëzuesin dhe Formën e aplikimit mund t'igjeni në faqen zyrtare të AKKSHI: <http://www.nasri.gov.al>